



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.645/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Kimete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Bejta Gashi, nga Podujeva, kundër vendimit me Nr.2279-2021 i datës 13.09.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale 2021 të datës 17.10.2021, në seancën e panelit, të mbajtur me datës 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i pasafatshëm apeli i identifikuar me numër Anr 645/2021 i datës 18.10.2021, e paraqitur nga Bejta Gashi nga Podujeva, kundër vendimit me Nr.2279-2021 i datës 13.09.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, Bejta Gashi me vendbanim në Podujevë, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën deklaron se si qytetar i këtij vendi i mohohet votimi i rregullt, sepse emri i tij nuk gjindet në listën e votimit. Kërkon nga PZAP të rregullohet kjo çështje sepse thekson se leternjofitim e ka në rregull por gabimin nuk e kupton.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Bejtush Gashi kundër vendimit, të KQZ-së, Nr.2279/2021 i datës 13.09.2021, me të cilin është certifikuar Lista e votuesve, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par.1 pika a) të LZP-së, ku përcaktohet: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP, brenda (24) orëve”*. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se certifikimi i listës përfundimtare të votuesve është bërë me datën 13 shtator 2021, ndërsa parashtruesi i apelit ka apeluar vendimin e KQZ-së, më datën 18 Tetor 2021, që do të thotë se afati për ankesë ka qenë 24 orë pas marrjes së Vendimit të KQZ-së për Certifikimin e Listës së Votuesve, Nr. 2279. Në këtë rast apeli është parashtruar me datë 18.10.2021, çka do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit të përcaktuar në dispozitën ligjore të nenit 122 par.1 të LZP-së.

Ndërsa sa i përket kërkesës që PZAP të rregulloj emrin e tij në listën e votuesve, kjo çështje nuk është në kompetencë të PZAP-it: sipas nenit 10.6 të LZP Gjykata e shkallës së parë ka

autoritetin për të urdhëruar KQZ-në për të marrë masa riparuese për çështjen në lidhje me Listën e Votuesve.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 par.1, dhe 118 par.4 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr. 645/2021 me datë 18.10.2021

Kryesues i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.